



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 7.3.2019

Lënda: Parashtrime të Komisionerit Publik Florian Ballhysa, në seancën gjyqësore të datës 7.3.2019, para Trupit Gjyqësor të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në çështjen ankim kundër vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Faqolli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5, i Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

I nderuar Trup Gjyqësor,

Në zbatim të nenit 55, pika 7 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në RSH”, pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë (IKP), më datë 13.8.2018, është njoftuar vendimi nr. 47, datë 25.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit z. Astrit Faqolli, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Komisioneri Publik, në mbështetje të nenit C, pika 2, nenit F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, brenda afatit 15-ditor nga njoftimi i vendimit, ka ushtruar ankim.

I. Procesi i rivlerësimit dhe përfundimet e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, në zbatim të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës dhe duke qenë se ka kandiduar për Këshillin e Lartë Gjyqësor, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio* dhe me përparësi në kohë.

2. Mbështetur në pikën 1, të nenit Ç, të aneksit të Kushtetutës, procesi i rivlerësimit për subjektin, z. Astrit Faqolli, ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kriterëve, atë të pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Nisur nga rezultatet e hetimit për secilin kriter dhe nga provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, bazuar në germën “a”, të pikës 1 të nenit 58, pika 1 e nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli. Ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga Komisioneri Publik.

Duke i qëndruar të gjitha shkaqeve të parashtruara në ankimin e Komisionerit Publik, kundër vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, parashtrorjmë si vijon:

II.A Vlerësimi i Komisionerit Publik mbi interpretimin ligjor të Komisionit

3. Komisioneri Publik konstaton se në arritjen e përfundimit për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Faqolli, *Komisioni* është mbështetur në disa arsytetime dhe qëndrime jo të sakta, lidhur me kuptimin dhe zbatimin e dispozitave kushtetuese dhe ligjeve të posaçme, qëndrime këto, të cilat meritojnë vëmendje nga ana e *Kolegjit*.

4. Komisioneri Publik nuk ndan të njëjtin qëndrim me sa parashtron dhe konkludon *Komisioni*¹ lidhur me interpretimin e nenit D (2) të aneksit të Kushtetutës, ku ndërmjet të tjerash arsyetohet se:

[...] pika 2 e nenit D të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzohë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë, dhe jo me deklaratimet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklaratimeve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë[...].

[...]Komisioni çmon se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaratat e viteve 2004 dhe 2005, pra jo në Deklaratën Vetting, që është dokumenti mbi të cilin bazohet rivlerësimi. Më tej, Komisioni arsyetohet se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarinë e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë[...].

5. Nisur nga rëndësia që paraqet ky interpretim i bërë nga *Komisioni* dhe efektet që ka mbi vendimin e marrë, në vijim paraqesim argumentet që në vlerësimin e Komisionerit Publik kundërshtojnë këtë interpretim të bërë nga *Komisioni*:

i. Dispozitat ligjore të zbatueshme. *Komisioni*, për të kryer rivlerësimin e kriterit pasuri, bën kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë sipas parimeve dhe sanksionimeve të nenit D të aneksit të Kushtetutës, kreut IV dhe disa dispozitave të kreut VII, të ligjit nr. 84/2016. Këtë vlerësim e nis nga të dhënat (deklarimet) që përmban *deklarata e re dhe e detajuar e pasurisë në përputhje me ligjin*. Ligji nr. 84/2016, në pikën 1 të nenit 31, përcakton detyrimin e subjektit të rivlerësimit të plotësojë deklaratën e pasurisë sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij ligji, e ashtuquajtura “*Deklarata Vetting*”, e cila ka si objekt deklarimi të gjitha pasuritë e akumuluarat ndër vite deri në ditën e dorëzimit të deklaratës së pasurisë. Sipas nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklaratimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë (pika 1), si dhe për

¹ Faqe 9 dhe 21 e vendimit.

personat e tjerë të lidhur detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive, kur ata janë deklaruar dhe konfirmojnë një marrëdhënie interesi (huadhënie, huamarrje, dhurimi) (pika 4), ndërkohë që deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë te ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga *Komisioni dhe Kolegji i Apelimit* (pika 5).

Sipas nenit 33, ILDKPKI-ja, bazuar në deklarimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin nr. 84/2016, ligjin nr. 9043/2004, ligjin nr. 9367/2004 dhe Kodin e Procedurave Administrative, duke përgatitur një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar. Sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, anëtarët e *Komisionit...* hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe, kur plotësohen së bashku tri kushte, pra subjekti i rivlerësimit: (i) arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; (ii) arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës; (iii) arrin një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, vendos konfirmimin në detyrë.

ii. Në kuptimin tonë, dispozita kushtetuese e pikës 2, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, kur sanksionon: “*Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar...*”, jep **renditjen e provave**, nga ku duhet të fillojë hetimi administrativ për kontrollin e pasurisë, por nuk përbën, nënkupton **shkakun** e vetëm mbi bazën e të cilit merret vendimi i *Komisionit*. Duke qenë **njëra nga provat**, ashtu sikurse aktet e tjera të administruara gjatë procesit të përcaktimit të gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen (neni 49 i ligjit nr. 84/2016), “*Deklarata Vetting*” nuk ka mbivlerë, pra natyrë prevaluëse mbi provat e tjera, sikurse janë edhe deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të dorëzuara më parë tek ILDKPKI-ja, për shkak të urdhërimit ligjor përkatës.

iii. Zbatimi i pikës 2, të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, ka qenë ndërkohë objekt i çështjeve të shqyrtuara nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, për të cilën ka vendimmarrje dhe është krijuar tashmë jurisprudencë, e cila ka si të përbashkët arsyetimet si vijon:

[...] *Deklarata Vetting* nuk është dokumenti i vetëm i mjaftueshëm për vendimmarrjen e *Komisionit*[...]².

[...] *Rivlerësimi* nuk mund të bëhet pa bazë krahasimore mes deklarimeve periodike dhe deklarimit të pasurisë “*Vetting*” 2017. Ballafaqimi i deklarimeve periodike me atë të bërë për efekt “*Vetting*” në vitin 2017 u jep mundësi institucioneve të rivlerësimit për të arritur në përfundimin nëse është bërë deklarim i saktë ose i pasaktë i pasurisë, është bërë ose jo fshehje e kësaj pasurie, nëse është i justifikuar burimi i të ardhurave dhe i pasurisë së deklaruar etj. të vendimeve të marra prej tij [...]³.

[...] *Dispozitat ligjore që rregullojnë vlerën e deklarimeve të bëra në deklaratat periodike dhe deklaraten e pasurisë së rivlerësimit janë neni Ç, pika 4 dhe neni D i aneksit të Kushtetutës, si dhe nenet 30, 32 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Sipas përcaktimeve të neneve të sipërcituara, si Kushtetuta, edhe ligji, kanë parashikuar shtrirjen e procesit të rivlerësimit edhe në shqyrtimin e deklarimeve periodike të pasurisë, të kryera në të shkuarën nga subjektet e rivlerësimit, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha sesa*

² Vendimi nr. 6/2018, nr. 7/2018.

³ Vendimi nr. 8/2018.

mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur [...].⁴

[...]Trupi gjykues vlerëson të nënvizojë që në fillim faktin se Komisioni, në përcaktimin që u bën qoftë pasaktësive, qoftë mospërputhjeve të deklarimeve, si shkaqe të renditura për shkarkimin e subjektit, nuk i identifikon ato në mënyrë të posaçme dhe as përcakton peshën apo rolin e tyre në drejtim të vendimmarrjes së Komisionit për shkarkim. Analiza e tyre në mënyrë të detajuar do të kryhet nga Trupi Gjykues në përgjigje të pretendimeve të subjektit në ankim, duke mbajtur në përfundim të analizës edhe një qëndrim për përdorimin e këtyre pasaktësive si shkaqe të mundshme për shkarkimin e subjektit [...].⁵

[...] Trupi Gjykues i Kolegjit të Apelit vlerëson se, pavarësisht se është e vërtetë që objekti i vlerësimit të pasurisë nga Komisioni është deklarimi i pasurive që i përkasin subjektit të rivlerësimit në momentin e Deklaratës Vetting (ex nunc), deklarimet periodike duhet të merren në konsideratë si prova në këtë vlerësim, për shkak se ato mund të hedhin dritë mbi burimet e krijimit të pasurisë dhe, në këtë mënyrë, edhe mbi ligjshmërinë e pasurisë.⁶

6. Për sa më sipër, arsyetimi i përdorur nga Komisioni nuk qëndron, për pasojë, edhe arsyet për të konfirmuar subjektin e rivlerësimit në detyrë, mbi bazën e këtij arsyetimi, nuk gjejnë mbështetje ligjore.

II.B Vlerësimi mbi pasuritë e paluajtshme të subjektit të rivlerësimit

Pasuria 1. *Apartament me sipërfaqe 83.31m², rruga “****”, Tiranë*

7. Në Deklaratën “Vetting”, subjekti ka deklaruar: Apartament banimi me sipërfaqe 83.31 m², me adresë rruga “****”, Tiranë, porositur me kontratën e sipërmarrjes së datës ***.1.2006, formalizuar me kontratën e shitblerjes me nr. *** rep./*** kol., datë ***.8.2015. **Burimi i krijimit:** të ardhurat familjare ndër vite. **Vlera e pasurisë:** 42.300 euro.

7.1 Në deklaratën vjetore të vitit 2006, subjekti ka deklaruar: Blerje apartamenti në tetor 2006, me sipërfaqe 93.4 m², me vendndodhje lagje “****”, Tiranë, e paregjistruar në ZRPP Tiranë. Vlera 42.030 euro. **Burimi i krijimit:** kursimet e mia dhe hua prej 10.000 euro, të marra nga shtetasi ***.*** (vëllai i bashkëshortes), hua e dhënë pa nënshkruar kontratë. **Pjesa takuese** 50% me 50%, bashkëshortja.

7.2 Në të njëjtën deklaratë, subjekti deklaron: përdorur nga gjendja *cash* e akumuluar në vitet 2003, 2004, 2005 për blerje shtëpie banimi, -2.300.000 lekë.

7.3 Komisioni për këtë pasuri i ka kaluar subjektit barrën e provës⁷, duke u shprehur se: (i) rezulton mospërputhje ndërmjet deklarimit të bërë në vitin 2006 me atë të Deklaratës Vetting, në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit; (ii) subjekti duhet të qartësojë shumën e deklaruar si pakësime nga *cash-i* në vitin 2006; (iii) subjekti duhet të qartësojë arsyen e deklarimit në “lekë të vjetra” në një dokument zyrtar (pasi ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara në deklaratat vjetore të viteve 2004 dhe 2005); (iv) subjekti duhet të provojë masën e fitimit nga aktiviteti “farmaci” e bashkëshortes, përkatësisht për medikamentet mjekësore dhe për mallrat e tjera të shitura në këtë farmaci (pasi

⁴ Vendimi nr. 9/2018.

⁵ Vendim nr.11/2018.

⁶ Vendimi nr.12/2018.

⁷ Shihni në dosje: “Relacion mbi rezultatet e hetimit për subjektin e rivlerësimit”, faqe 6.

Komisionit i ka rezultuar se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruar në deklaratën e vitit 2003).

7.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni arsyeton sa vijon: (i) huadhënësi, z. ***.***, ka pasur aftësi huadhënie⁸; (ii) subjekti ka qenë i pasaktë në deklarin e pakësimit të gjendjes *cash* në vitin 2006⁹; (iii) dhe (iv) Komisioni konstaton se subjekti ka gabuar në deklarin e kursimeve të tij për vitin 2004 dhe 2005, duke përdorur për këtë deklarin nocionin “*lekë të vjetër*”. Por subjektit nuk mund t’i mohohet vërtetësia e deklarin të kursimeve në vitin 2003, për shumën 5.000.000 lekë, duke pasur parasysh të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i farmacisë në pronësi të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga paga e vetë subjektit. Komisioni vlerëson se subjekti ka gabuar, duke mos i dhënë rëndësi dhe kushtuar kujdes një dokumenti zyrtar. Në të njëjtën kohë, Komisioni arsyeton se ky gabim nuk mund të konsiderohet i qëllimshëm, përderisa nuk arrihet të vërtetohet se mund të kemi të bëjmë me fshehje të burimit të ligjshëm apo fshehje të pasurisë¹⁰. Nga ana tjetër, Komisioni çmon se kemi të bëjmë me një pasaktësi në deklaratat e viteve 2004 dhe 2005, pra jo në Deklaratën Vetting, që është dokumenti mbi të cilin bazohet rivlerësimi. Më tej, Komisioni arsyeton se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3, të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarin të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklartës Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë apo kur tenton të kryejë fshehje, apo deklarin të rremë të pasurisë¹¹.

8. Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje, për sa parashikohet nga neni D (1) dhe D (3) i aneksit të Kushtetutës, në ndryshim nga konkluzionet e Komisionit, vlerëson se:

- a. Në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, që ka mundësuar huadhënien për subjektin e rivlerësimit, në vlerën prej 10.000 euro, nuk është i bazuar në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016.
- b. Në lidhje me kursimet e deklaruar, të përdorura për blerjen e pasurisë, rezulton se kursimi në *cash* i deklaruar nga subjekti: (i) nuk mbulohet me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, konkretisht kursimi i deklaruar në masën 5.000.000 lekë, nga subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, nuk justifikohet me të ardhura të ligjshme, pasi subjekti dhe bashkëshortja e tij *nuk kanë pasur* të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të krijuar kursimin e deklaruar dhe analiza financiare e bërë nga Komisioni nuk mbështetet në dokumente provuese, që vërtetojnë deklarinet e subjektit për sa i përket marzhit të fitimit, përcaktues në burimin e ligjshëm të krijimit të të ardhurave nga aktiviteti privat, farmaci e bashkëshortes, detyrim ky i parashikuar në nenin 32 të ligjit 84/2016 dhe (ii) subjekti, në mënyrë të vazhdueshme, ka kryer deklarime të pasakta lidhur me kursimet e viteve 2004 dhe 2005 dhe përdorimin e tyre lidhur me blerjen e pasurisë apartament.
- c. Në lidhje me shumën prej 250.000 lekësh, që vjen si rezultat i shitjes së automjetit Mercedes Benz 240, në vitin 2006 dhe përdorur nga Komisioni në analizën financiare

⁸Faqe 25, paragrafi 8.

⁹Faqe 22, paragrafi 4.

¹⁰Në vendimet e tij nr. 6/2018, nr. 9/2018, nr.10/2018, Kolegji i Posaçëm i Apelit ka mbajtur qëndrimin se dispozitat kushtetuese dhe ligjore për procesin e rivlerësimit, për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarin me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit.

¹¹Faqe 21, paragrafi 3 dhe 4.

si një nga zërat përbërës të të ardhurave të ligjshme të subjektit për blerjen e pasurisë, nuk provohet me dokumentacion justifikues.

Sjellim në vëmendjen e Kolegjit se Komisioneri Publik, për këtë çështje, ndan të njëjtin qëndrim me atë të pasqyruar edhe në opinionin e datës 21.7.2018, të përfaqësuesit të ONM-së, depozituar pranë Trupës Gjyquese të KPK-së.

9. (a) Lidhur me burimin e ligjshëm të të ardhurave, që kanë shërbyer për dhënien e huas prej 10.000 euro, nga z.*.***.**

9.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, e ka deklaruar këtë marrëdhënie interesi në deklaratën e interesave vetjakë/periodikë vjetorë të vitit 2006. Sipas deklaratës noteriale¹² të qershorit 2018, të bërë nga z.***.***, subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, prej tij i është dhënë shuma 10.000 euro si hua. Në të njëjtën deklaratë përcaktohet se kjo hua: *është likuiduar nga kunati im Astrit Faqolli dhe nuk kam pretendime për të*. Rezulton se asnjë nga transaksionet, si huadhënia ashtu dhe shlyerja, nuk janë kanalizuar nëpërmjet sistemit bankar.

9.2 Fillimisht në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14¹³ të ligjit nr. 84/2016, për z. ***.***, duke qenë se ka pasur lidhje interesi, që rrjedh nga një interes pasuror (marrëdhënia e huas), nga Komisioni duhet të konsiderohej si person tjetër i lidhur. Në zbatim të nenit 32, pika 4¹⁴, të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se me deklaratë noteriale konfirmohet kjo marrëdhënie, qëndron detyrimi i justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

9.3 Për aftësinë huadhënëse dhe burimin e ligjshëm, Komisioni, pas hetimit të kryer, dhe marrjes në pyetje të dëshmitarit, z. ***.***, shpjegon në mënyrë kronologjike këto rrethana:

- (i) Z. ***.***, së bashku me bashkëshorten, znj.***.***, ka pasur në pronësi apartament me sipërfaqe 135 m², në rrugën “***”, qyteti Tiranë.
- (ii) Subjekti i rivlerësimit, z. Faqolli, ka deklaruar se pas ardhjes së tij nga Librazhdi në Tiranë, nga viti 2003 deri në vitin 2006, kur ka blerë banesën e tij në rrugën “***”, familja e tij ka banuar pa pagesë pikërisht në këtë apartament, të blerë në vitin 2000, nga ana e personit tjetër të lidhur, z. ***.***, dhe bashkëshortes së tij.
- (iii) Në datë ***.12.2006, z. ***.*** dhe znj. ***.*** kanë lëshuar prokurë të posaçme¹⁵ me anë të së cilës emërojnë përfaqësues të posaçëm z. Faqolli dhe i japin të drejtën të shesë apartamentin në fjalë. Nga verifikimi i sistemit TIMS nuk ka rezultuar që z. ***.*** dhe bashkëshortja e tij ka qenë në Shqipëri në këtë ditë kur është lëshuar prokura e posaçme. Subjekti i rivlerësimit dhe z. ***.*** deklarojnë ardhjen në territorin shqiptar përmes rrugës tokësore nga Prishtina, për shkak të një situatë të rënduar shëndetësore të një familjari.
- (iv) Më datë ***.12.2006 është lidhur Kontrata e Shitjes¹⁶ për apartamentin me çmim 5.900.000 lekë, shumë nga e cila, me miratimin e z. ***.***, 10.000 euro i ka mbajtur subjekti i rivlerësimit si hua. Për këtë është lëshuar Deklarata Noteriale¹⁷ e qershorit

¹² Deklaratë Noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2018, bërë në Tiranë, para noterit ***.***.

¹³ “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisionerin, Gjyqtarin ose Komisionerin publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

¹⁴ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

¹⁵ Prokurë e posaçme nr. *** rep., nr.*** kol., lidhur në Tiranë, para noterit ***.***

¹⁶ Kontratë shitje nr. *** rep., nr.*** kol., e datës ***.12.2006, bërë në Tiranë, para noterit ***.***

¹⁷ Deklaratë Noteriale nr.*** rep., nr. *** kol., datë ***.6.2018, lidhur në Tiranë, para noterit ***.***

2018 nga z. ***.*** (babai i ***.*** dhe njëkohësisht vjehri i subjektit të rivlerësimit), ku deklarohet “mbajtja e shumës 10.000 euro nga dhëndri im Astrit Faqolli me miratimin e dhënë nga djali im”.

- (v) Subjekti i rivlerësimit deklaron se këtë hua ia ka dhënë (shlyer) ai vetë prindërve të huadhënësit, për shkak se ky i fundit jetonte në Zvicër. Për të provuar këtë fakt, subjekti ka vënë në dispozicion Deklaratën Noteriale të qershorit të vitit 2018, bërë nga z. ***.***.

Asnjë nga veprimet e deklaruara nuk rezultojnë të jetë bërë nëpërmjet kanalit bankar.

- (vi) Subjektit të rivlerësimit, z. Faqolli, i është kërkuar të depozitohet edhe deklarata tatimore vjetore për të ardhurat e huadhënësit në Zvicër, për periudhën 2006-2009. Subjekti ka depozituar gjashtë dokumente, që i përkasin periudhës shkurt 2008, dhjetor 2011, dhjetor 2013, tetor 2015 dhe nëntor 2017.

9.4 Komisioni, në përfundim të sa më lart, që e cilëson si analizë, shprehet se: rezultojnë se huadhënësi ka pasur aftësi huadhënie. Fakti që kjo hua nuk është dokumentuar, mund të shpjegohet me afërsinë në lidhje gjinore ndërmjet huadhënësit dhe huamarrësit. Një marrëdhënie e tillë e afërt vërtetohet edhe nga fakti se këtë apartament, për të cilin u argumentua më sipër, subjekti i rivlerësimit e ka përdorur si vendbanim të tij për një kohë të gjatë pa pagesë.

10. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, ky përfundim i Komisionit, në lidhje me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, që ka mundur huadhënien për subjektin e rivlerësimit, në vlerën prej 10.000 euro, nuk është i bazuar në prova dhe në dispozitat e ligjit nr. 84/2016. Ky konkluzion i Komisionit, përveç faktit se nuk provon ligjshmërinë e burimit, vlerësojmë se është i pabazuar, pasi nuk mbështetet në asnjë analizë financiare.

10.1 Siç u tha më sipër, deklarimi fillestar për huan e marrë është bërë në Deklaratën periodike të vitit 2006, por ky burim nuk deklarohet në Deklaratën “Vetting”. Gjithashtu nga krahasimi i Deklaratës vjetore 2006 dhe përgjigjeve¹⁸ dhënë Komisionit nga subjekti i rivlerësimit, z. Faqolli, vërehen kontradikta lidhur me përdorimin e kësaj huaje. Nga njëra anë, subjekti në Deklaratën vjetore 2006 deklaron se e ka përdorur për të blerë apartamentin, ndërkohë që në përgjigjet dhënë Komisionit, në qershor 2018, shprehet se nga kjo hua, 850.000 lekë janë përdorur për mobilim dhe diferenca,¹⁹ është mbajtur *cash* në banesë.

10.2 Z. ***.*** pohon se huaja është dhënë *cash* dhe vlera prej 10.000 euro është siguruar nga shitja e apartamentit prej 135 m² në rrugën “***.***”, Tiranë, blerë nga shoqëria e ndërtimit “**.*” sh.p.k.,²⁰ për shumën 41.000 USD (ka sqaruar edhe pse vlera në kontratë është 2.700.000 lekë) dhe shitur për vlerën 5.900.000 lekë. Në deklaratimet e tij si dëshmitar, personi tjetër i lidhur, z. ***.***, ka deklaruar se për periudhën 1997-2000: “...jetojmë në Zvicër prej vitit 1997, ku kam studiuar me bashkëshorten dhe pasi vendosëm të qëndrojmë përfundimisht atje, dhe blemë shtëpi në Zvicër. Shtëpia e shitur në Tiranë ka qenë si e vetmja gjë që kam bërë më të ardhurat nga karriera si futbollist. Na duhej njëfarë kapitali për të blerë shtëpi atje”.

10.3 Subjekti i rivlerësimit, z. Faqolli, në cilësinë e provës për ekzistencën e aftësisë financiare të personit tjetër të lidhur, z. ***.***, për të dhënë hua, ka paraqitur kontratën e shitjes së

¹⁸ Shiko faqe 4 të përgjigjeve, protokolluar në Komision nr. *** prot., datë ***.6.2018 dhe nr. ***, datë ***.6.2018.

¹⁹ Rreth 400.000 lekë, shënim i Komisionerit.

²⁰ Kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr.*** kol., datë ***.12.2000.

apartamentit me sipërfaqe 135 m² në rrugën “***.***”, si dhe gjashtë dokumente (fotokopje të thjeshta) në gjuhën gjermane (me përkthim të thjeshtë në gjuhën shqipe), për periudhën shkurt **2008**, dhjetor **2011**, dhjetor **2013**, tetor **2015** dhe nëntor **2017**. Nga ana formale, këto dokumente nuk kanë fuqi provuese, sepse janë kopje pa vulë apostile dhe nuk vërtetohet nënshkrimi i përkthimit nga noteri publik²¹. Ndërkohë që Komisioni kishte kërkuar deklaratimet tatimore të të ardhurave të huadhënësit në Zvicër, për periudhën 2006-2009.

10.4 Po t’i referohemi arsyetimit të *Komisionit* dhe përmbajtjes së akteve të administruara, ka mospërputhje të dukshme. Nga ana e *Komisionit* rezulton se nuk është administruar asnjë provë mbi ligjshmërinë e krijimit të pasurisë së personit tjetër të lidhur, z.***.***, që ka shërbyer si burim për dhënien e huas. Kontrata e shitjes e vitit 2006 shërben për të provuar ekzistencën e të ardhurave në momentin e huadhënies, por nuk justifikon burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë në vitin 2000 nga ana e personit tjetër të lidhur.

10.5 Në zbatim të nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës, nenit 3, pika 4, 30 dhe nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, Komisioni duhet të dilte në përfundimet përkatëse për ligjshmërinë e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, vetëm pasi të krijonte bindjen se ato (të ardhurat) ekzistojnë në momentin e blerjes së apartamentit dhe se ekzistenca e tyre justifikohet nga burime të ligjshme.

10.6 Subjekti i rivlerësimit, duke pranuar këtë marrëdhënie, si dhe huadhënësi në cilësinë e personit tjetër të lidhur, kanë pasur detyrimin ligjor për të provuar dhe justifikuar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj të ardhure, jo në momentin e shitjes, por në momentin e blerjes.

11. (b) Lidhur me kursimet e deklaruara, të përdorura për të blerë pasurinë apartament

11.1 Nga verifikimi i deklaratave të interesave periodikë vjetorë të administruar në dosjen e subjektit të rivlerësimit, rezulton se subjekti ka deklaruar:

- Në deklarimin e tij të parë, para fillimit të detyrës, depozituar pranë ILDKPKI-së, datë ***.3.2004, subjekti ka deklaruar pasuri kursime *cash* gjendje në banesë, në shumën 5.000.000 lekë.
- Në deklaratën e interesave privatë, dorëzuar në ILDKPKI, në datë ***.3.2005, subjekti ka deklaruar shtim të kursimeve *cash* në banesë, në shumën 1.000.000 lekë.
- Në deklaratën e interesave privatë, dorëzuar në ILDKPKI, në datë ***.3.2006, subjekti ka deklaruar shtim të kursimeve *cash* në banesë, në shumën 800.000 lekë.

11.2 Nga deklaratimet e mësipërme të subjektit të rivlerësimit rezulton se subjekti, në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes, datë ***.1.2006, posedon kursime në banesë në *cash*, në shumën 6.800.000 lekë, shumë kjo që mundësonte pagesën e plotë të vlerës së çmimit të sendit (pa pasur nevojë të lidhte një marrëdhënie huamarrje me kунatin për vlerën 10.000 euro).

12. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruara.

12.1 Fillimisht mbi kursimin fillestar, i deklaruar në DV 2003, në shumën 5.000.000 lekë.

12.2 Subjekti deklaron se kursimi prej 5.000.000 lekësh ka burim kryesor të ardhurat nga aktiviteti privat i bashkëshortes, “farmaci”.

²¹ Shiko faqen 25 të vendimit të Komisionit.

12.3 Mbi justifikimin e të ardhurave nga ky aktivitet, subjekti ka vënë në dispozicion të ILDKPKI-së dhe Komisionit shkresën numër ***, datë ***.10.2016, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan, me të cilën jepet informacion mbi të ardhurat e deklaruara nga subjekti “farmaci”. Në këtë shkresë nuk referohet qarkullimin real i aktivitetit, por për vitet 1999-2002 konfirmohet: xhiro e deklaruar deri në 2.000.000 lekë, duke referuar fashën ku përfshihet aktiviteti.

12.4 Komisioni ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të cilët kanë përcjellë kërkesën pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan. Kjo e fundit, në përgjigjen e saj, datë ***.2.2018, ka konfirmuar se për shtetasen ***.***, e cila rezultoi e regjistruar me NIPT ***, nuk disponohen të dhëna për qarkullimin dhe fitim/humbjen ndër vite, nuk ka detyrime në kohë reale dhe nuk disponohen të dhëna mbi pasqyrat financiare dhe kontributet e sigurimeve shoqërore të deklaruara.

12.5 Në këto kushte, analiza jonë financiare është bazuar vetëm në shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan nr. *** prot., datë ***.10.2016, si e vetmja provë shkresore mbi qarkullimin (xhiron e aktivitetit).

12.6 Mbi këto të dhëna, duke konsideruar xhiron e aktivitetit në limitin maksimal të fashës së deklaruar dhe marzhin e fitimit nga ky biznes prej 35%, po në limitin maksimal të xhiros, sipas VKM-së nr. 182, datë 25.4.1995, niveli i kursimit i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit rezultoi sa 83% e të ardhurave totale familjare të periudhës deri në 2003 (në 100 lekë të ardhura, kursehen 83 lekë), një marzh ky ekstremisht i lartë kursimi. Nga analiza financiare e të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të jetesës dhe atyre të deklaruara, rezultoi se subjekti dhe bashkëshortja nuk mbulojnë më të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar në vitin 2003 për një shumë prej - 1.167.787 lekësh (referohuni tabelës nr. 1).

Tabela nr.1

Analizë financiare për kursimet e deklaruara	Lekë
Totali të ardhura familjare deri në 2003 (I)	6.014.356 ²²
Shpenzime deri në vitin 2003 (II)	2.182.143 ²³
Kursime të deklaruara (III)	5.000.000
Diferencë e pambuluar e kursimeve (V=I-II-III)	(1.167.787)

12.7 Pamundësinë e subjektit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme kursimin në *cash* të deklaruar në DV 2003, e ka konstatuar fillimisht dhe Komisioni. Subjekti në shpjegimet e tij, të protokolluara pranë Komisionit, datë ***.06.2018, ka pohuar se marzhi i fitimit të aktivitetit “farmaci” mund të shkonte deri në masën 40%, si rezultat i shitjes së artikujve kozmetikë, të cilët kishin një marzh më të lartë fitimi. Këtë pretendim të tij, subjekti i rivlerësimit nuk e ka shoqëruar me asnjë dokumentacion provues, edhe pse i është kërkuar shprehimisht nga Komisioni.

²² Të ardhurat nga biznesi i bashkëshortes, llogaritur me marzh maksimal fitimi 35% dhe të ardhurat e subjektit sipas vërtetimeve nga organet përgjegjëse.

²³ Shpenzime minimale për jetesën, si dhe shpenzimet për blerje autoveture dhe truall, sipas deklarimeve të subjektit.

12.8 Edhe pse në mungesë të depozitimit të dokumentacionit justifikues mbi fitimin e aktivitetit të bashkëshortes, Komisioni ka rilogaritur fitimin e supozuar nga ky aktivitet me marzhin e deklaruar nga subjekti në masën 40%, duke arritur në një rezultat të ndryshëm dhe, tanimë, vlerëson se subjekti mbulon me të ardhura të ligjshme kursimin e deklaruar prej 5.000.000 lekësh.

12.9 Në analizën financiare të kryer nga Komisioni, rezulton se në përlllogaritjen e burimeve të ligjshme për të mbuluar kursimin e deklaruar, nuk janë marrë në konsideratë si shpenzime vlera prej 500.000 lekësh, të cilën vetë subjekti i rivlerësimi e ka deklaruar në vitin 2004 si shpenzime të kryera gjatë vitit 2003, respektivisht 150.000 lekë për blerje trualli, në datë ***.7.2003 dhe 350.000 lekë për blerje automjeti, në datë ***.1.2003.

12.10 Arsytimi i Komisionit se: *subjektit nuk mund t'i mohohet vërtetësia e deklarimit të kursimeve në vitin 2003 për shumën 5.000.000 lekë, duke pasur parasysh të ardhurat e siguruara nga aktiviteti i farmacisë në pronësi të bashkëshortes, si dhe të ardhurat nga paga e vetë subjektit, nuk qëndron dhe është i pabazuar në dokumentacion justifikues.*

13. Lidhur me kursimet e deklaruar në vijim në vitet 2004 - 2005

13.1 Subjekti në deklaratën periodike vjetore të vitit 2004 deklaroi kursime në shumën 1.000.000 lekë dhe 800.000 lekë kursime të tjera në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005. Nga analiza financiare e të ardhurave të ligjshme dhe shpenzimeve të viteve 2004 dhe 2005, ashtu si edhe Komisionit në qëndrimin e parë të tij, na rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme kursimet e deklaruar.

13.2 Fillimisht, Komisioni gjithashtu ka arritur në përfundimin që subjekti nuk kishte mundësitë financiare për të krijuar kursimet e deklaruar në vitet 2004 -2005, madje as për të paguar këstin e parë të apartamentit²⁴, duke i kaluar subjektit barrën e provës sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016. Vetë subjekti, në përgjigjet e pyetësorëve, gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në shpjegimet përfundimtare para Komisionit, datë ***.7.2018, pohon se deklarimi i vlerave të kursimeve më sipër është i pasaktë dhe thekson që kursimet në vitin 2003 i ka deklaruar në “lekë të rinj”, ndërsa në vitin 2004 dhe 2005 deklarimet janë në “lekë të vjetër”.

13.3 Lidhur me konceptin e monedhës zyrtare nga subjekti, Komisioni konstaton se subjekti ka gabuar në deklarimin e kursimeve të tij për vitin 2004 dhe 2005, duke përdorur për këtë deklarim nocionin “lekë të vjetër”, duke mos i dhënë rëndësi dhe kushtuar kujdes një dokumenti zyrtar, duke konsideruar si të paqëllimshme deklarimet e pasakta lidhur me kursimet në deklaratat e viteve 2004 -2005, me argumentin se janë bërë në deklarimet periodike dhe jo në atë Vetting. Komisioni arsyeton se kjo pasaktësi nuk lidhet me deklarimin e pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016. Nxjerrja e konkluzionit për “deklarim të pamjaftueshëm”, në lidhje me pasurinë, bëhet mbi bazën e shkakut kushtetues, kur vërtetohet se subjekti, sipas Deklaratës Vetting, nuk arrin të justifikojë burimin e ligjshëm të pasurisë, apo kur tenton të kryejë fshehje apo deklarim të rremë të pasurisë²⁵.

13.4 Ky argument i Komisionit bie ndesh me nenin 32, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelimit.

²⁴ Shihni faqen 19 të vendimit.

²⁵ Shihni faqen 21 të vendimit.

13.5 Marrë në konsideratë formimin profesional të magjistratit/gjyqtar, prezumohet se subjekti ka aftësitë e mjaftueshme për të kuptuar rëndësinë e dokumenteve zyrtare dhe përgjegjësinë që pasjellë një deklaram i tillë, pasi shqyrtimi i dokumenteve është pjesë e ushtrimit të detyrës së tij. Gjithashtu, argumenti i Komisionit është jobindës, pasi subjekti në deklaramin fillestar periodik vjetor të vitit 2003, përpara fillimit të detyrës së tij, nuk ka pasur “gabime të tilla”, duke deklaruar saktë vetëm monedhën zyrtare “lekë të rinj”. Shpjegimi i subjektit nuk qëndron as logjikisht, pasi brenda së njëjtës deklaram²⁶ subjekti *gabon vetëm* në deklaramin e kursimeve në “lekë të vjetër”, ndërsa *të ardhurat i deklararon drejt*, në “lekë të rinj”.

13.6 Subjekti në deklaramen periodike të vitit 2006 deklaroi *pakësimin e kursimeve në masën 2.300.000 lekë*. Duke marrë në konsideratë deklaramet e subjektit për likuiditetin e përdorur për blerjen e kësaj pasurie, shuma totale 2.300.000 lekë +1.237.000²⁷ lekë = 3.537.000 lekë, nuk justifikon blerjen e apartamentit në vlerën 5.232.000 lekë.

13.7 Në përgjigjet e tij, protokolluar në KPK, në datë ****.6.2018*, subjekti sqaron *se shuma e kursyer deri në vitin 2006 ka qenë 5.180.000 lekë dhe e gjitha kjo shumë është përdorur për blerjen e apartamentit. Huaja nga kunati, pjesërisht në vlerë 850.000 lekë është përdorur për arredimin e tij, ndërsa diferenca e mbetur është mbajtur cash në shtëpi*. Në të njëjtin pyetësor, subjekti bën deklarame kontradiktore lidhur me kursimet, duke deklaruar shprehimisht: *në DV 2006 kam deklaruar për blerje shtëpi banimi pakësimin e kursimit në shumën 2.300.000 lekë. Mënyra e të shprehurit në deklaramen nuk ka qenë e duhura dhe jo e saktë, pasi, si dhe sqarova më sipër, vlera e apartamentit është likuiduar e gjitha brenda vitit 2006 dhe për këtë është përdorur e gjithë gjendja cash në shumën 5.180.000 lekë*.

13.8 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni konstaton se deklarami i subjektit për pakësimin *cash* të shumës 2.300.000 lekë, nuk përputhet me asnjë nga deklaramet e mëpashme, të bëra pas vitit 2006 dhe as mbi llogaritjet mbi bazën e dokumentacionit të administruar. Në shpjegimet e subjektit mbi rezultatet e hetimit, protokolluar në KPK, me nr. **** prot.*, datë ****.7.2018*, ai konfirmon qëndrimin e Komisionit dhe nuk ka paraqitur asnjë provë²⁸ për të konsideruar si të vërtetë deklaramin e bërë prej tij në 2006.

13.9 Nga provat e administruara në dosje²⁹ dhe shpjegimet e palëve, në vlerësimin tonë, ky deklaram i pakësimit të *cash*-it nga subjekti nuk është i vërtetë dhe lidhet drejtpërdrejt me detyrimin e tij për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe, në gjykimin tonë, vlerësojmë që subjekti është përpjekur të fshehtë dhe paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi³⁰.

Sjellim në vëmendjen e Kolegjit se Komisioneri Publik për këtë çështje ndan të njëjtin qëndrim me atë të pasqyruar edhe në opinionin e datës 21.7.2018, të përfaqësuesit të ONM-së, depozituar pranë Trupës Gjykuese të KPK-së.

²⁶ Shihni rubrikën kursime dhe të ardhura në deklaramen periodike 2004, ashtu edhe në atë 2005.

²⁷ Kundërvlera në lekë e huas së deklaruar 10.000 euro me kursin mesatar të vitit 2006.

²⁸ Në përputhje me nenin 52, të ligjit 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të provuar të kundërtën.

²⁹ Sipas mandateve të pagesave bashkëlidhur shkresës së shoqërisë “***” sh.p.k., datë ****.7.2018*, rezultoi se gjendja *cash* për vitin 2006 është pakësuar në vlerën e çmimit të blerjes së pasurisë 2, në shumën 5.180.000 lekë.

³⁰ Detyrim parashikuar në nenin D të aneksit të Kushtetutës.

14. (c) Lidhur me shitjen e automjetit

14.1 Në DV 2006, subjekti ka deklaruar dhe shitjen e automjetit tip Mercedes Benz 240, për vlerën prej 250.000 lekësh. Në vendimin e Komisionit,³¹ kjo shumë është trajtuar si e ardhur e vitit e subjektit të rivlerësimit dhe është përfshirë në të ardhurat totale të përdorura për krijimin e pasurisë apartament.

14.2 Nga verifikimi i akteve në dosje nuk rezulton të jetë dokumentuar asnjë dokument justifikues (kontratë) lidhur me shitjen e këtij aseti, krijimin e të ardhurave prej tij dhe trajtimin e tyre si të ardhura të ligjshme, në kuptim të ligjit 84/2016. Ky deklaram i subjektit është marrë i mirëqenë nga Komisioni në kundërshtim me përmbajtjen e akteve në dosje.

15. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri Publik, në ndryshim nga sa ka vlerësuar Komisioni, çmon se lidhur me pasurinë nr.1, apartament me sipërfaqe 83.31 m,² burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm, i) kursimet deri në vitin 2006, ii) huaja nga personi tjetër i lidhur z. ***.*** dhe iii) shitja e automjetit tip Mercedes Benz, nuk rezultojnë të jenë provuar se janë burime të ligjshme në masën e kërkuar, sikundër sanksionon pika 1, 3 dhe 5 e nenit D, të aneksit të Kushtetutës.

Subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, blerjen e pasurisë për një shume totale prej rreth 2.4 milionë lekësh³².

16. Pasuria 2. Ndërtesë 3 kate me vendndodhje qyteti Librazhd.

16.1 Në Deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: Truall me sipërfaqe 32 m,² blerë në vitin 2003, me kontratë shitje nr.*** rep./*** kol., me vlefhtë 150.000 lekë dhe ndërtesë 3 kate mbi këtë truall, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** rep./*** kol., datë ***.3.2011, me vlerë totale sipas situacionit 2.786.720 lekë. **Burim i krijimit,** nga të ardhurat familjare ndër vite. Pjesë takuese regjistruar në emër të subjektit.

16.2 Në deklaratën e interesave vjetorë të vitit 2011, subjekti ka deklaruar: Ndërtuar me leje ndërtimi në truallin prej 32m², ndërtesë 3 kate në qytetin e Librazhdit. **Burimi i krijimit,** kursimet e deklaruara në vitet e mëparshme dhe hua nga një i afërm, shtetasi ***.***, hua pa interes dhe afat. **Pjesë takuese** 50% subjekti i rivlerësimit dhe 50% bashkëshortja.

16.3 Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, duke u shprehur se nuk përputhet shuma e shpenzuar për ndërtimin e këtij objekti me deklaramin e subjektit në deklaratën e pasurisë për vitin 2011.

16.4 Komisioni ka arsyetuar sa vijon: (A) *Pavarësisht se subjekti e ka justifikuar shumën e deklaruar në vitin 2011 për këtë pasuri, mbetet fakt mospërputhja e këtij deklarimi me atë të Deklaratës Vetting. Në lidhje me këtë, Komisioni arsyeton se pika 2, e nenit D, të aneksit të Kushtetutës ka përcaktuar detyrimin e subjektit të dorëzojë/plotësojë një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë. Sipas Kushtetutës, dokumenti ligjor, prej ku fillon të evidentohen përgjegjësitë e subjektit për shkelje disiplinore, është pikërisht kjo deklaratë dhe të dhënat që ajo përmban. Kushtetuta e ka lidhur drejtpërdrejt përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit me Deklaratën e re të Pasurisë dhe jo me deklarimet e mëparshme të tij. Këto deklarime mund të*

³¹ Faqe 22 e vendimit.

³² Diferenca negative e konstatuar në kursimet e vitit 2003, kundërvlera e huas prej 10.000 euro dhe të ardhurat nga shitja e automjetit.

shërbejnë si provë për Komisionin në proces, por nuk mund të jenë shkak për shkarkimin e subjektit. Konkluzioni përfundimtar i Komisionit do të duhet të nxirret nga motivi dhe sjelljet e subjektit, nga mënyra e plotësimit të Deklaratës Vetting dhe nga të dhënat e hedhura në të. Përdorimi i deklaramëve në vite shërben për të analizuar vlerën e kësaj prove në raport me provat e tjera, me qëllim përcaktimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë.

Në analizë të rezultatit hetimor të mësipërm, vlerësohet se subjekti ka qenë plotësisht i saktë në deklarimin e tij në Deklaratën Vetting, duke pasqyruar vlerën e objektit të ndërtuar, ashtu siç edhe formulari e kërkon: “Përshkruani hollësisht pasurinë, ...vlerën në lekë apo në valutë që pasqyrohet në dokumentacionin që dispononi...”. Subjekti ka deklaruar në përputhje me dokumentacionin e disponuar: “Vlera e situacionit të punimeve të ndërtimit pasqyrohet në shumën 2.786.720 lekë”. Ndërsa, referuar formularit të deklarimit të vitit 2011, subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit të shtesave dhe pakësimeve gjatë vitit kalendarik. Nëse subjekti do të kishte deklaruar këtë vlerë në vitin 2011, ai do të kishte qenë në kushtet e shkëljes së ligjit për deklarimin në atë vit, sepse bazuar në dokumentacion, ai ka pasur detyrimin të deklaronte edhe ato shpenzime që ka kryer për vënien e pronës në shfrytëzim. Këto shpenzime nuk e kanë rritur vlerën e pronës. Vlera e saj është ajo e paraqitur në situacionin e punimeve. Në përfundim të kësaj analize, Komisioni konstaton se subjekti ka qenë i saktë në deklarimin e tij³³.

(B) [...] Por, nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezulton se banka “****” ka konfirmuar në favor të shtetasit ***, tri arkëtime në vitin 2009 nga firma “****”, me vlera përkatësisht 1.000.000 lekë, 500.000 lekë dhe 1.000.000 lekë. Bazuar në këto të dhëna, Komisioni vlerëson se z. *** ka pasur aftësi huadhënëse në këtë shumë³⁴.

17. Komisioneri Publik, referuar gjendjes së akteve në dosje për sa parashikohet nga neni D (1) dhe D (3) i aneksit të Kushtetutës, vlerëson dhe konkludon se:

- a. Nuk justifikohet ligjshmëria e burimit të krijimit të shumës prej 1.000.000 lekë (një milion) si hua e dhënë nga shtetasi ***.***, në muajin gusht 2011.
- b. Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, nuk ka pasur mundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasurinë e krijuar në vitin 2011 për një shumë totale prej 1.400.000 lekë (një milion e katërqind mijë).

18. (a) Lidhur me konstatimin se nuk justifikohet burimi i ligjshëm për shumën 1.000.000 lekë si hua

18.1 Subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, e ka deklaruar këtë marrëdhënie interesi në deklaratën e interesave vetjakë/periodikë vjetorë të vitit 2011. Sipas deklaratës noteriale³⁵ të marsit 2012, të bërë nga z. ***.***, subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, prej tij i është “...dhënë hua në shumën 1.000.00 lekë të reja, në muajin gusht 2011, pa afat dhe pa interes, me qëllim ndërtimin e objektit 3-katësh në qytetin e Librazhdit”. Kjo hua është deklaruar në vlerën 1.000.000 lekë dhe transaksioni është kryer jashtë sistemit bankar.

³³ Faqe 9 e vendimit, paragrafët 3,4.

³⁴ Shihni vendimin faqe 12, paragrafi 1.

³⁵ Deklaratë noteriale nr.*** rep., nr.*** kol., datë ***.3.2012, bërë në Librazhd, para noterit ***.***.

18.2 Fillimisht në përputhje me parashikimin e nenit 3, pika 14,³⁶ të ligjit nr. 84/2016, për z. ***.**, duke qenë se ka pasur lidhje interesi, që rrjedh nga një interes pasuror (marrëdhënia e huas), duhet të konsiderohet si person tjetër i lidhur. Në zbatim të nenit 32, pika 4,³⁷ të ligjit 84/2016, duke qenë se me deklaratë noteriale konfirmohet kjo marrëdhënie, qëndron detyrimi i justifikimit të ligjshmërisë së burimit të krijimit të të ardhurave.

18.3 Për aftësinë huadhënëse dhe burimin e ligjshëm, Komisioni, pas hetimit të kryer, arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka: i) marrëdhënie farefisnie me huadhënësin; ii) nga informatat që ai kishte, ka pasur të ardhura nga emigracioni në shtetin grek, për periudhën 1992-2002, si dhe iii) ka aktivitet privat në fushën e ndërtimit si person fizik i regjistruar, nga viti 2005.

18.4 Nga ana dokumentare, Komisioni ka administruar korrespondencën me bankën “***”, nga ku janë konfirmuar në favor të z. ***.**, person fizik në fushën e aktiviteteve në ndërtimtari, i regjistruar me NIPT përkatës, tri arkëtime në muajt shkurt-mars **2009**, nga shoqëria “***” sh.p.k., me vlera përkatësisht 1.000.000 lekë, 500.000 dhe 1.000.000 lekë. Komisioni vlerëson se z. *** ka pasur aftësi huadhënëse në këtë shumë.

18.5 Ky konkluzion i Komisionit, se z. ***.**, në gusht **2011**, dy vjet e gjysmë pas këtyre arkëtimeve si person fizik, ka pasur aftësi huadhënëse në shumën 1.000.000 lekë, nuk është i mbështetur në analizë edhe të dokumentacionit tjetër të administruar nga Komisioni dhe më konkretisht sa vijon:

- shkresa nr. ***, datë ***.6.2018, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë;
- shkresa nr. *** prot., datë ***.4.2018, e Qendrës Kombëtare të Biznesit.

18.6 Nga këto dokumente rezulton që aftësia (mundësia) huadhënëse e personit fizik ***.**, duke konsideruar të tillë fitimin e deklaruar në organet tatimore sipas viteve, respektivisht është si vijon:

- për vitin 2008 në shumën 960.394 lekë;
- për vitin 2009 në shumën 31.836 lekë;
- për vitin 2010 nuk ka deklaratë të dorëzuar në organin tatimor;
- për vitin 2011 nuk ka deklaratë të dorëzuar në organin tatimor.

19. Sa më sipër, Komisioneri Publik, duke marrë në konsideratë dhe nivelin minimal të jetës të llogaritur për vitet 2008-2011, vjen në përfundimin se, ndryshe nga sa arsyeton Komisioni, z. ***.** nuk ka pasur mundësi huadhënëse për subjektin e rivlerësimit në shumën 1.000.000 lekë. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arrin të shpjegojë bindshëm burimin e krijimit të pasurisë. Për sa kohë aftësia huadhënëse e personit tjetër të lidhur nuk ekziston, atëherë aq më pak mund të pretendohet ekzistenca e burimit të ligjshëm.

Sjellim në vëmendjen e Kolegjit se Komisioneri Publik për këtë çështje ndan të njëjtin qëndrim me atë të pasqyruar edhe në opinionin e datës 21.7.2018, të përfaqësuesit të ONM-së, depozituar pranë Trupës Gjyquese të KPK-së.

20. (b) Lidhur me pamundësinë e të ardhurave në shumën 1.400.000 lekë

³⁶ “Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, Komisionerin, Gjyqtarin ose Komisionerin Publik, që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

³⁷ Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

20.1 Bazuar në arsyetimin ligjor sa më sipër dhe analizën financiare, për krijimin e kësaj pasurie, që merr në konsideratë nivelin e kursimeve të akumuluar gjatë viteve 2007-2011, të mbuluara me të ardhura të ligjshme, mungesën e provave për mundësinë e huadhënies nga personi tjetër i lidhur, z. ***.***, vlerën totale të ndërtimit prej 2,983,619 lekësh (sipas deklaratimit të subjektit dhe mbështetur në dokumentacionin ligjor të vënë në dispozicion), si shpenzim i vitit 2011, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, nuk ka pasur mundësi për të mbuluar me të ardhura të ligjshme pasurinë e krijuar në vitin 2011 për një shumë prej 1.4 milion lekë, në vijim tabela nr. 2.

Tabela nr. 2

Deklarata e interesave vetjakë/periodikë vjetorë 2011	Të ardhura të ligjshme (lekë)
Gjendja në llogaritë bankare në fillim të vitit	142.059,02
Gjendje <i>cash</i> e akumuluar (sipas deklaratave vjetore)	1.000.000 ³⁸
Të ardhura nga pagat (total familje)	1.442,440
Shpenzime për ndërtim	2.983,619
Shpenzime minimale konsumi	642.857,14
Shpenzime udhëtimi	238.959,01
Shpenzime mobilimi	35.000 ³⁹
Gjendja në llogarite bankare në fund të vitit	87.763,82
Diferenca në mbulimin e shpenzimeve	(1.403.700,04)

21. Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri Publik, në ndryshim nga sa ka vlerësuar Komisioni, çmon se lidhur me pasurinë nr. 2: *truall+ndërtesë tre kate me sipërfaqe 32 m² (32m²+32m²+48m²), në qytetin e Librazhdit*, subjekti i rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në zbatim të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Të dyja burimet e deklaruara për krijimin e të ardhurave në vlerën prej 2.983,619 lekë, që kanë shërbyer për fitimin e pronësisë së sendit të paluajtshëm: i) huaja nga personi tjetër i lidhur, z. ***.*** dhe ii) kursimet e viteve 2007-2010, nuk mbulohe me të ardhura të ligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3, e aneksit të Kushtetutës.

22. Deklarime kontradiktore gjatë procesit të rivlerësimit mbi justifikimin e likuiditeteve ndër vite

22.1 Mbi kursimet e deklaruara ndër vite, në pyetësorin nr. ***, i pyetur nga Komisioni nëse me këto shuma i referohen kursimit gjendje në banesë apo atij në llogaritë bankare, subjekti deklaroi se ka qenë i pasaktë mbi plotësimin e likuiditeteve dhe, në seksionin përkatës, në deklaratat vjetore, ka deklaruar shtesën në *cash*, duke pasur parasysh dhe shtesat e likuiditeteve në llogaritë bankare, duke justifikuar kështu dhe mosdeklarimin e balancave të llogarive bankare për periudhën deri në 2016, disa vite, të konstatuara nga Komisioni.

22.2 Nisur nga ky fakt, Komisioni, pasi referon shkresën nr.*** prot., datë ***.4.2018, të ILDKPKI-së, sqaron se ligji 9049/2003, botuar në Fletoren Zyrtare të majit 2003, përcakton shprehimisht detyrimin e subjekteve të deklarojnë: “*d*) vlerën e likuiditeteve, gjendje *cash*, në

³⁸ Kursime vitet 2007-2010.

³⁹ Subjekti deklaroi se për periudhën 2006-2016 ka shpenzuar 350.000 lekë për mobilim/arredim. Duke mos deklaruar periudhën e saktë, shpenzimi i është përlllogaritur në mënyrë lineare për vitet 2006-2016.

llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie...”, pra të gjitha në një zë, pa përcaktuar detyrimin për t’i ndarë në zëra.

22.3 Komisioneri Publik vlerëson se kuptimi i Komisionit nuk është i drejtë, pasi nga mënyra e formulimit të dispozitës, kuptohet që likuiditetet mund të jenë në disa forma *cash*, në *llogari rrjedhëse*, në *depozitë*, në *bono thesari* dhe në *huadhënie*, pra janë në disa forma dhe duhen deklaruar në mënyrë korrekte sipas formës dhe vendit ku gjenden. Vetëm në këtë mënyrë, duke i paraqitur në zëra të veçantë, garantohet efektiviteti i kontrollit të tyre, pasi, nëse nuk identifikohet se ku është likuiditeti, nuk mund të realizohet kontrolli efektiv.

22.4 Nga verifikimi i deklaratave vjetore dhe balancave të llogarive bankare të vëna në dispozicion nga institucionet financiare, nuk konfirmohet sa më sipër deklaroi subjekti. Në DV 2012, subjekti ka deklaruar shtesë në kursime shumë 200.000 lekë, burimi: kursime nga puna e kryer. Ndërkohë, nga llogaria e bashkëshortes së subjektit pranë ***, konstatohet se në këtë vit llogaria rrjedhëse e pagës së saj është shtuar me vlerën 357.196 lekë, si rezultat i kalimit të pagave gjatë vitit 2012 (nuk rezulton të jetë e deklaruar as balanca e llogarisë në DV 2012).

22.5 Në vitin 2016, subjekti deklaroi të ketë shlyer huan prej 1.000.000 lekësh ndaj shtetasit ***,*** dhe 7500 euro ndaj shtetasit ***,***. Komisioni ka konstatuar pamundësinë financiare të subjektit të rivlerësimit për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shlyerjen e huave dhe i ka kaluar barrën e provës.

22.6 Subjekti ka deklaruar se shuma e likuiditetit e llogaritur në fillim të periudhës nga Komisioni nuk është e saktë, pasi likuiditetet (kursimet *cash*) të deklaruara nga subjekti në DV 2015 kanë qenë në total 700,000 lekë (f. 27 e vendimit) dhe jo 400.000 lekë. Komisioni ka rillogaritur aftësinë financiare të subjektit mbi bazë të deklaratimeve të tij dhe ka konkluduar në një diferencë negative josingjifikative, duke konfirmuar mundësinë e subjektit për shlyerjen e huave me të ardhura të ligjshme.

22.7 Nga verifikimi DV 2014 dhe 2015 konstatohet se subjekti deklaroi kursime konkretisht në DV 2014: *gjendje në cash jashtë sistemit bankar 300,000 lekë*; DV 2015: *gjendje në cash jashtë sistemit bankar 400,000 lekë*, pra subjekti në të dyja rastet i referohet gjendjes në momentin e deklarimit, jo shtimit të shumave të kursyera.

22.8 Nga analiza financiare e të ardhurave të ligjshme dhe deklaratimeve të subjektit rezulton se subjekti nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet vjetore (në mënyrë të përmbledhur në tabelën e mëposhtme).

Tabela nr. 3

Viti		2012	2016
Total të ardhura		1,405,881	2,905,456
Likuiditete në fillim të periudhës sipas DV		87,763.82	480,380.30
Shpenzime	Konsumi	642,857.14	642,857.14
	Udhëtimi	348,975	405,690
	Investime	0	0
	Shkollimi	0	652,755.21
	Të tjera	35,000	35,000
	Shlyerje huaje	0	2,014,225
Totali i shpenzimeve vjetore		1,026,832.14	3,750,527.35
Likuiditete në fund të periudhës		634,110	139,043
Diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve		(167,297.32)	(503,734.05)

22.9 Në konkluzion të sa më sipër analizuar, deklaratimet e subjektit kanë qenë në mënyrë të përsëritur kontradiktore. Subjekti, pasaktësisht në deklaratimet vjetore të interesave privatë duhej t'i kishte deklaruar dhe saktësuar në deklaratat e tij gjatë periudhave të mëparshme dhe jo gjatë procesit të rivlerësimit, sa herë që nga Komisioni konstatohej mosmbulim më të ardhura të ligjshme të kursimeve dhe shpenzimeve të deklaruara.

22.10 Për sa më sipër konkludojmë se deklaratimet kontradiktore të subjektit kanë pasur qëllim justifikimin e shpenzimeve dhe kursimeve të deklaruara, dhe subjekti ka kryer deklaratim të pamjaftueshëm.

III. Kërkimi i ankimit

23. Nisur nga parashikimi i nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenit C (2), D, Ç dhe F (3), të aneksit të Kushtetutës, konsiderojmë se vendimi nr. 47, datë 25.7.2018, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit, z. Astrit Faqolli, referuar akteve të administruara nga vetë Komisioni, nuk ka qenë i drejtë, konform Kushtetutës dhe ligjit, për të krijuar bindjen se subjekti i rivlerësimit ka nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë së tij në kuptim të nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, si dhe rezulton se ka bërë deklaratim të pasaktë dhe paplotë në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të aneksit të Kushtetutës, si dhe deklaratim të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016;

24. Duke ritheksuar se Komisioneri Publik ka detyrimin që të ushtrojë kontroll mbi vendimet e dhëna nga Komisioni, me qëllim që të garantojë mbrojtjen e interesit publik në procesin e rivlerësimit, duke vlerësuar nëse vendimmarrja e Komisionit për konfirmimin ose shkarkimin e magjistratit, ose ndërprerjen e procesit të rivlerësimit është marrë në përputhje me ligjin, në përfundim të një hetimi të plotë, mbështetur në faktet dhe provat e administruara në fashikullin përkatës për çdo subjekt;

25. Referuar pikës 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, ku sanksionohet se: *“...7. Kolegji lë në fuqi, ndryshon ose rrëzon vendimin e Komisionit, duke dhënë vendim me shkrim të arsytuar. Në rastet e ankimeve nga Komisioneri Publik, Kolegji nuk mund të vendosë një masë më të rëndë, pa i dhënë subjektit të rivlerësimit kohë të mjaftueshme për t'u përgatitur dhe për t'u dëgjuar në seancë”*;

26. Kërkojmë që shkaqet e këtij ankimi të merren në shqyrtim nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, dhe mbështetur në provat e mbledhura, në zbatim të germës “b”, të nenit 66 dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 47, datë 25.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Astrit Faqolli.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA